



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Studime Pasdiplomike-Cikli i Dytë

Fakulteti i Gjuhëve Kulturave dhe Komunikimit

Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe

Teza: Të folmet shqipe në rajonin e Drenicës

Mentori: Prof. dr. Zeqir Kadriu

Studentja: Arbesa Selmani-Geci

Tetovë, 2020

Mirënjohje

Duke e rikujtuar shprehjen e famshme të Shekspirit të *Hamleti*, “Si i varfër që jam, jam edhe i varfër në falenderime”.

Do të mundohem që sadopak të shpreh një mirënjohje të thellë, **pikë së pari** për profesorët e mi të cilët gjatë këtyre viteve studimore më kanë mundësuar që përveç që të studioj gjuhën tonë të bukur edhe të kaloj një kohë **të mirë të kohës për ta kujtoj si një periudhë** të bukur të rinisë sime.

Falenderoj **poashtu** familjen time të ngushtë që më kanë motivuar të arrij sot këtu ku jam.

Ju falemnderit të gjithëve!

Deklaratë

Unë, Arbesa Selmani-Geci, studente e Universitetit të Evropës Juglindore, në degën e Gjuhës dhe Letërsisë shqipe – studime të ciklit të dytë, nëpërmjet kësaj deklarate vërtetoj se jam autore e këtij punimi dhe **me përgjegjësi morale mbroj** originalitetin e tij.

Ky punim është **punuar** në bazë të njohurive të **mia** dhe deklaroj se çdo pjesë e marrë nga autorë të tjerë është cituar siç duhet **në bazë të rregullave etike për punën kërkimore-shkencore**.

Punimi u realizua përveç me literaturën e shfrytëzuar, edhe me anë të përgjigjeve nga pyetësorët dhe anketimet, përgjigjet e të cilëve i kam marrë personalisht nga personat e anketuar dhe të cilët i kam përpunuar dhe rezultatet e tyre i kam paraqitur me saktësi.

Abstrakti

Kjo temë diplome trajton, në thelb, disa prej vecorive kryesore në shprehjet dhe të folurit ditor në dy komunat e Drenicës, Skënderajin dhe Drenasin. Gjuha të cilën e flet një dendësi popullore e caktuar paraqet jo vetëm identitetin e tyre por edhe kulturën, shprehitë, dhe karakterin që ajo gjuhë ndjell në vete.

Si një prej mrekullive më të mëdha në tokë, gjuha përmban një rëndësi vitale për bashkëjetesën në shoqëri, prandaj çdo studim në lidhje me gjuhën është i frytshëm dhe mund të tejkaloj barrierën kohore, si shembull mund të sjellim shkrimin e egjiptasve të vjetër, pra hieroglifet të cilat sot na mundsojnë që të kuptojmë shumë më lehtë jetën dhe veprën e njerzve që jetonin në tokën e pjellshme të Egjiptit të asaj kohe. Njëlloj, mund të sjellim shembullin e gjuhës Latine dhe asaj Greke që ende sot ndikojnë në folësin e gjuhëve indoevropiane. Pra, duke marrë parasysh faktin që gjuhët ndryshojnë me kohën dhe se shumica e gjuhëve ngërthejnë në vete dialekte të ndryshme, është mjaft e rëndësishme që të mbajmë evidencë për këto ndryshime. Si rrjedhojë e kësaj, ky punim do të fokusohet në po këtë fushë.

Pasiqë fonetika dhe fonologjia janë dy prej fushave kryesore të linguistikës, unë jam munduar që të hulumtoj me metoda bashkëkohorë shkencore ndryshimet në zanoret, bashkëtinglloret, apo edhe në vetë fjalët apo shprehjet në të folurit ‘vulgar’ të Drenicës. Pra, këto ndryshime do të paraqesin, ndër të tjera, edhe qiellëzorzimin e disa bashkëtinglloreve apo edhe moshqiptimin e disa zanoreve në fillimin, mesin, apo edhe fundin e një fjale. Sigurisht, aty-këtu, do të fokusohem edhe në disa ndryshime sematike që kanë ardhur si rrjedhojë e ndryshimeve

dialektologjike. Fonologjia, edhe pse fushë në vete, ka një ndërlidhje të fuqishme me të gjitha fushat e tjera gjuhësore.

Gjithashtu, gjuha jonë njihet botërisht për rregulla të shumta gramatikore, si përshembull lakimin e emrave nëpër rasa apo zgjedhimin e foljeve nëpër kohët e ndryshme. Prandaj, një pjesë e madhe e këtij punimi do të ketë pikësynim trajtimin e këtyre rregullave në të folurit në Drenicë.

Fjalët kyçe: Drenica, dialektologji, të folurit, fonologjia, ndryshimet, gjuha

Abstract

This thesis, in essence, deals with some of the main features in daily expressions and dialects in two municipalities of Drenica, Skenderaj and Drenas. The language spoken by a given folk density represents not only their identity but also the culture, habits, and the character that the language insemminates.

As one of the greatest miracles on earth, language has a vital significance for co-existence in society. Therefore, any language-related study is fruitful and can overcome the time barrier, as an example we can bring forth is the writing scheme of old Egyptians, hence the hieroglyphs which today enable us to understand more easily the lives and works of the people who lived on the fertile land of Egypt during that time.

Likewise, we can bring the example of Latin and Greek that still affect the speaker of any Indo-European language today. So, considering the fact that languages alterate with time and that most languages incorporate different dialects, it is very important to keep track of these changes. As a result, this paper will focus on that particular field. Since phonetics and phonology are two of the main areas of linguistics, I have tried to explore with contemporary scientific methods the changes in vowels, consonants, or even in whole words or expressions in Drenica's "vulgar" speech. So, these changes will include, among other things, the palatalization of some of the consonants or even the deletion of some vowels in the beginning, middle, or even the end of a word.

Of course, here and there, I will also focus on some schematic changes that have come as a result of dialectological changes. Phonology, although a separate field in itself, has a strong linkage with almost all other language fields. Also, our language is universally recognized for numerous grammatical rules. Therefore, a large part of this paper will aim at addressing these rules in regards to the speech in Drenica.

Key words: Drenica, dialectology, speech, phonology, alterations, language

Titulli punues i temës:

“Të folmet shqipe në rajonin e Drenicës”

Përkthimi i titullit punues në maqedonisht:

“кои зборуваат набљудувања во регионот Дреница”

Përkthimi i titullit punues në anglisht:

“Observations on the Spoken Dialect of Albanian in the Region of Drenica”

Përmbajtja

1.1 Hyrja.....	
1.2 Çka është dialektologjia?	
2.1 Studime të hershme të dialektologjisë shqipe.....	
3.1 Shqipja standarde dhe dialektet.....	
3.2 Disa veçori morfologjike të së folmes së Drenicës.....	
3.3 Emri.....	
3.4 Shumësi i emrave.....	
3.5 Rasat.....	
3.5.1 Rasa thirrore.....	
3.5.2 Rasa rrjedhore.....	
3.5.3 Nyja e trajtës së pashquar.....	
3.5.4 Nyja e përparme.....	
3.5.5 Nyja e prapme.....	
3.6 Mbiemri.....	
3.7 Numërori.....	
3.8 Ndajfolja.....	
3.9 Parafjala.....	
3.10 Lidhëza.....	
3.11 Pjesëza.....	

3.12 Fjalëformimi.....	
3.13 Parashtesat.....	
4.1 Studim hulumtues dhe statistikor i së folmes së Drenicës.....	
5.1 Përfundimi.....	
Bibliografia.....	

Kaptiulli i parë

1.1 Hyrja

Çdo e dhënë faktike mbi ndryshimet dialektore në të folurit e një rajoni specific ndikojnë në ngritjen e vetëdijes së një populli për vjetërsinë dhe zhvillimin e gjuhës që ata e flasin. Sigurisht, të dhëna të tilla do të na ndihmonin edhe sot për të krijuar një lidhje edhe më të ngushtë me Ilirishten e cila mendohet të jetë gjuha jonë prejarshëse.

Sot, kudo në Kosovë, të gjithë mund të dallojnë prejardhjen e një individi duke u bazuar në të folurit e tyre. Këto ndryshime, shpeshherë mjaft të cekta, nuk i ikin askujt. Dialekti i rajonit të Drenicës, në vecanti, ndryshon mjaft shumë nga ai i rajonit të Anamoravës apo Dukagjinit, ani pse nuk ka shumë kilometra që i ndajnë.

Në temën time, unë do të përpiqem që të përpiloj një pasqyrë të këtij dialekti dhe të bëj një tezë me laryshi ndikimesh gjuhësore që karakterizojnë këtë dialekt me kaq dallime në te shkruar, shqiptim, dhe gramatikë. Sigurisht, gjuha standarde shqipe është e ndërtuar mbi një variant gjuhe, pra një dialekt (ai i toskërishtes), dhe të gjitha dialektet tjera të saj janë pjesë e asaj gjuhe dhe të kuptueshme lehtasi nga të gjithë shqipfolësit në mbarë botën. Gjuha arabe, për shembull, për dallim nga gjuha jonë, ka disa dialekte të cilat janë të pakuptueshme për disa fise tjera arabe. Ne kemi fat që të gjitha variantet apo dialektet tona janë të lidhura ngushtë me gjuhën standarde.

Prioritet në këtë temë do të jetë shpjegimi i dallimeve të shqiptimit të disa prej fjalëve të përditshme në atë rajon, por, siç edhe e kemi cekur më herët, nuk do të përjashtojmë ndryshimet që poashtu ndodhen në të shkruar dhe në semantikë. Shumë fjalë, që realisht mund të duken si të

njëjta në shqiptim apo edhe në ortografi, mund të kenë kuptime krejtësisht të kundërta, përshebull, në Viti, në rajonin e Anamoravës, shprehja “është sosur” nënkupton diçka që është harxhuar, pra, si shembull, ata thonë: “është sosur dija në popull” ndërsa në Drenicë ajo shprehje përdoret në një kontekst krejt ndryshe, përshebull, në themi: “është sosur ushqimi”. Pra, në me atë fjalë nënkuptojmë diçka që është gatuar apo pjekur së tepërmi. Kështu lloj krahasimesh do të përcjellin shumicën e këtij hulumtimi.

Si pasojë e globalizimit, me theks të vecantë rolit të medias, më saktësisht programeve televizive dhe mediave sociale si Facebook dhe të tjerat, sot gjuha mund të pasojë ndryshime të mëdha brenda shumë më pak kohe sesa në të kaluarën. Nëse e shikojmë të folurit e anglishtes që prej vitit 1066 e këndej mund të vërejmë që për një ndryshim të vogël në shqiptim apo të shkruar ka marrë kohë me shekuj të tërë. Sot, një studiues i anglishtes mund të lexoj dhe ta kuptoj me mjaft lehtësi gjuhën e Shekspirit i cili ka shkruar gjatë viteve 1500-1600. Sidoqoftë, si në anglisht ashtu edhe në shqip, sot hasim fjalë të shumta të cilat duken të huaja për të gjithë ne. Krejt kjo si rrjedhojë e huazimeve të shumta nga gjuhët e tjera por edhe një mode të re që ka për synim një lojë me fjalë, përshebull shpeshherë mund të hasim fjalën “op” si zëvendësim për fjalën pohuese “po”. Njësoj, fjala “riçke” si zëvendësim për fjalën “kqyre, shikoje, vëreje”.

Në asnjë mënyrë ky hulumtim nuk do të ketë për qëllim ndonjë imponim apo gjykim mbi ndonjë shprehje apo fjalë, sado vulgare të jetë ajo. Ky punim thjesht do të mundohet të paraqesë me precizitet ndryshimet që po ndodhin dita ditës dhe potencialisht do të mundohet të bëjë disa krahasime midis dialektit të sotëm dhe atij që e kemi hasur në disa vite më parë, para internetit.

Për më tepër, një prej qëllimeve tjera kyçe për këtë temë është edhe shpjegimi se si rrethanat të ndryshme kanë ndikuar në këto ndryshime të mëdha gjuhësore në atë trevë të Kosovës.

Në qendrën e Skënderajit apo Drenasit nxënësit shpesh dëgjoen duke thënë: “Çka po bon?” ndërsa në fshatra, përshembull në fshatin Runikë, afro 15 kilometra larg Skënderajit, nxënësit thonë: “Çka po ban?”. Ndryshimi midis zanoreve ‘o’ dhe ‘a’ shpesh shfrytëzohet si mjet dallues për origjinën e atyre nxënësve.

Ndër të tjera, do të hulumtojmë edhe ngjashmërinë që ka e folmja e Drenicës me atë të Shqipërisë së veriut, më saktësisht rajonit të Shkodrës. Sipas Bahri Becit, “Një ndër ngjashmëritë në fushën e morfologjisë ndërmjet të folmeve të Kosovës dhe të folmes së Shkodrës është formimi i trajtës së shquar të emrat e gjinisë mashkullore që sosin me ‘i’ të theksuar gojore me anë të prapashtesës – **ja**.

Ky punim poashtu synon që në bazë të teknikave dhe hulumtimeve që janë përdorur të jap një pasqyrë të këtij dialekti në veçanti. Aty jemi munduar të paraqesim veçoritë dalluese siç janë ato semantike dhe fonologjike për të paraqitur një studim sa më të besueshëm të dialektit të rajonit të Drenicës. Me pak fjalë, mund të themi se qëllimi i këtij punimi do të ngërthejë në vete një mori veçorishë gjuhësore që e bëjnë rajonin e Drenicës një rajon me një të folur dallues brenda territorit të vogël të shtetit kosovar.

1.2 Çfarë është dialektologjia?

Termi dialekt rrjedhë nga fjala latine *dialectus* dhe greqishtja *dialektos* dhe i referohet dy tipeve të ndryshme të një fenomeni gjuhësor. Dialektologjia, në anën tjetër, është shkenca që i studion dialektet.

I pari prej këtyre përdorimeve i referohet një variacioni të një gjuhe që është karakteristikë e një grupi të vecantë folësish. Nën këtë definicion dialektet ose variacionet e një gjuhe janë afërsisht të ndërlidhura dhe, pavarësisht dallimeve mes tyre, janë shpesh mutalisht të kuptueshme. Ky term më së shpeshti i referohet një të folmeje regjionale por një dialekt mund të definohet edhe nga faktor të tjerë, si për shembull klasa sociale ose etniciteti. Një dialekt që është i ndërlidhur me një klasë të veçantë sociale quhet ndryshe edhe sociolekt, në anën tjetër një dialekt që është i lidhur me një grup të vecantë etnik njihet edhe si etnolekt. Definicionet e termeve “gjuhë” dhe “dialekt” mund të përzihen dhe janë shpesh subjekt debati, me ndryshimet midis dy klasifikimeve shpesh të motivuara nga motive arbitrare apo sociopolitike. Termi dialekt shpeshherë është i rezervuar vetëm në kuptimin e një variacioni gjuhësor jostandart.

Kuptimi tjetër i termit dialekt përfshin edhe një gjuhë e cila është e ndërruar nga një gjuhë tjetër, shpesh herë historikisht gjenetikisht e ndërlidhur me gjuhën dominuese standard, por jo domosdoshmërisht e prejardhur prej saj.

Një dialekt është i njohur dhe i dallueshëm nga të tjerët përmes fjalësit, gramatikës, dhe shqiptimit (fonologjisë). Aty ku bëhet dallimi vetëm në bazë të shqiptimit termi theks është më i preferueshëm se sa dialekt.

Kapitulli i dytë

2.1 Studimet e hershme të dialektologjisë shqiptare

Ky punim, ashtu siç edhe u përmed disa herë më parë, ka një rëndësi të madhe për të folurit e gjuhës shqipe në Drenicë duke marrë parasysh se ajo trevë e Kosovës është studiuar mjaft pak nga albanologët e hershëm. Ekzistojnë vetëm pak të dhëna mbi dialektin e atjeshëm dhe nuk duhet të harrojmë që në Kosovë një elitë e madhe politike dhe kulturore rrjedh nga ai vend. Si rrjedhojë, dialekti i Drenicës është mjaft i përhapur në masmedia gjithandej.

Së dyti, ka aq shumë fjalë nga ai rajon të cilat kanë qenë në përdorim pëe shekuj me radhë të cilat sot po shuhen shumë shpejt nga rinia e cila është e obsesionuar me fjalët e huaja që po hyjnë në shqip me furi të madhe. Në fakt, gjuha shqipe po rrezikohet shumë nga të gjitha ato fjalë që po vijnë nga anglishtja apo gjermanishtja dhe të cilat në fakt nuk na nevojiten sepse kemi disa fjalë të ndryshme për një send dhe nuk kemi nevojë që të huazojmë ndonjë tjetër. Nga e gjithë kjo katahurëduhet që doemos të ruajmë dhe të kultivojmë dialektin Drenicas ashtu që të mos zhduken fare nga fjalori ynë.

Gjuha si element parësor paraqet zhvillimin dhe përfeksionimin e njeriut qëështë arritur në mënyrë paralele që prej fillimeve të para të njerëzimit. Duke parë rëndësinë e gjuhës si një ndër mjetet që ka ndikuar në progresin e shoqërisë, jam perpjekur që këtë hulumtim, sado që mund të jetë i një përmase të vogël, të kontribojë në shtjellimin dhe studimin e mëtutjeshëm të gjuhës Shqipe, me theks të veçantë duke u fokusuar në të folmen e rajonit të Drenicës.

Prapë, duke qenë se unë i takoj rajonit të Drenices, ka qenë më e lehtë për të nxjerrë të dhëna faktike të bazuara në përvojën personale dhe gjithashtu duke konsultuar një literaturë të gjerë.

Përveç kësaj, kemi bërë edhe hulumtime në terren, siç e kam cekur më parë, që kanë dalë të jenë shumë frytdhënëse në studimet gjuhësore që i kemi bërë.

Rezultatet dhe përfundimet që kam nxjerrë nga metodat e hulumtimit kanë konstatuar që ky dialekt ka tipare dalluese nga dialektet e tjera dhe është një thesar që duhet ruajtur dhe studiuar me kohën. Veçori dalluese ishte pjesa semantike dhe leksikologjia e fjaleve.

Ky dialekt ka një diapozon të gjërë të fjalëve tëveçanta që mungojnë në dialekte të tjera. Dallimet më të spikatura janë ato fonologjike ku fjalët dallojnë me dialektet e tjera nga shndërrimi i zanoreve që është bërë me kalimin e kohës. Zanoret si ‘o’ dhe ‘a’ janë shumë më të zakonshme, si shembull mund të marrim fjalët në vijim: ‘hala’ në rajonin e Anamoraves përdoret për në kontekstin që diçka nuk ka përfunduar akoma ndërsa ‘hale’ përdoret në të njëjtin kontekst sikurse në rajonin e Anamoraves. Këto dallime të dialektit të rajonit të Drenicës nxjerrin në pah veçoritë që unë do t’i studioj më tej.

Gjuha shqipe, ja vlen të theksohet, për një mori arsyesh të ndryshme, qofshin ato historike, gjeografike, apo ekonomike, ndër shekuj është ballafaquar me ndikime të ndryshme nga gjuhë të huaja të cilat kanë ndikuar bukur shumë në leksikun e saj, dhe gjithashtu kanë ndikuar edhe në krijimin e disa varianteve apo dialekteve të ndryshme që edhe sot e kësaj dite dallojnë mjaft shumë nga njëra-tjetra.

Gjuha shqipe, pjesë e grupit të gjuhëve indoevropiane, ka ngjallur interesimin e gjuhëtarve jo vetëm vendas por edhe atyre të huaj. Në fakt ishtenjë gjuhëtar francez i cili kishte përpunuar ngjashmëritë e gjuhës shqipe me ato të gjuhëve indoevropiane. Sidoqoftë, gjuha shqipe mbetet e vetme në pemën e atyre gjuhëve si e vecantë.

Duke e konsideruar territorin e popullit shqiptar si mjaft të vogël në krahasim me disa vende të tjera evropiane apo botrore është mjaft interesante shqyrtimi i dialekteve të shumta që ekzistojnë ende sot. Dialekti i Drenicës, përshembull, dallon mjaft shumë nga ai i rajonit të Dukagjinit edhe pse janë vetëm afro 10 kilometra që i ndajnë nga njëra-tjetra. Me të folurit e rajonit të Dukagjinit, Anamoravës, apo të Shqipërisë së veriut është shkruar mjaft, por të folurit në Drenicë është hulumtuar mjaft pak.

Hapja e kufinjve shqiptar ndaj atyre të huaj në Evropë, shumë e mirë pritur si politikisht ashtu edhe kulturalisht, nuk mund të mos sillte me vete edhe ndikime të shumta të gjuhëve të tyre. Dalja e shumë shqiptarve në Itali, Gjermani, Francë, dhe Amerikë gjithashtu ka ndikuar që të folurit në Drenicë të ketë një numër fjalësh të reja që përdoren edhe sot. Pastaj, shumë Drenicas të gjeneratës së re mësojnë gjuhën angleze qysh në vegjëli, prandaj edhe kjo gjuhë po ka ndikim të jashtëzakonshëm në të folurit e kësaj treve. Natyrisht, gjuha shqipe si të gjitha tjerat ka nevojë që të pasurohet me fjalë të reja që t'i përshtatet nevojës së gjuhës së kompjuterit dhe teknologjisë në përgjithësi. Por, shumë shpesh përdoren fjalë angleze aty ku ne tashmë kemi fjalën tonë e cila shumë shpesh është edhe më e bukur dhe e përshtatshme sesa ajo e huaja. Sipas shkrimtarit Vesel Nuhju, “Shumë njerëz përdorin një fjalë të huaj në vend të asaj shqipe për arsye mode: kjo ndodhë veçanërisht kur ajo gjuha ka një prestigj të lartë në vend ose në botë.”

Për dallimet mes dialekteve në Kosovë ka shkruar mjaft shumë linguisti i mirënjohur Idriz Ajeti, i cili konstatoi, duke studiuar librat fetar të Hilmi Maliqit, se gjuha shqipe ka qenë originalisht mjaft e pasur me hundorësi, siç është zanorja hundore ‘a’.

“kush t’i gjan,

duhet vehten me lan, tuj than,

me ngran,

e kan banun...”

Kjo zanore hundore ka mbijetuar mjaft mirë në të folmen e Drenicës deri më sot. Në Drenicë pothuajse gjithësecili thotë: “Po vij me hanger”, “po shkoj me e lan”, “E ngova tuj than”, etj. Këto zanore dhe disa bashkëtingllore në të folurit e Drenicës do të hulumtohen më poshtë.

Kapitulli i tretë

3.1 Shqipja standarde dhe dialektet

Formimi i një gjuhe standarde varet nga shumë vecori të ndryshme. Varianti përfundimtar arrihet duke u bazuar në variante ekzistuese. Ato mund të jenë variante që përdoren në një regjion të caktuar ose edhe përzierje e varinave të ndryshme.

Kur marrim parasysh rastin e shqipes, kemi pasur një zgjidhje më të thjeshtë. Zakonisht, në formësimin e një gjuhe gërmëtohen dialekte të ndryshme, në rastin tonë është përzgjedhur dialekti i toskërishtes për tu përzgjedhur si gjuhë standarde.

Në si linguistë e kemi parasysh që përvetësimi i gjuhës standarde vjen më natyreshmë për folësit e dialektit të jugut, pasi që, siç u përmend më parë, gjuha standarde është e bazuar në të.

Të arriturat e shoqërisë shqiptare si integrimet dhe zhvillimet e saj, kanë krijuar rrethana dhe mundësi që edhe të rishikohet gjuha standarde, aty ku ka mundësi të plotësohet apo të ndryshohet. Rishikimi i gjuhës duhet të bëhet sipas parametrave të rregullave gjuhësore duke mos mënjeluar elementet gjuhësore-dialektore të cilat e pasurojnë gjuhën standarde dhe shtojnë funksionalitetin e saj. Ne nuk duhet të xjerrim përfundime të shpejta duke sugjeruar se duhet ndërruar standardja që nga fillimi, ajo vetëm duhet të pasurohet me leksikun e fjalëve që kanë origjinë nga dialekte të ndryshme, dhe nga burimi i pastër popullor i shqipes. Asnjë dialekt nuk duhet të mënjanohet nga mundësia për të marrë fjalë, nëse shihet si zgjidhje adekuate dhe e arsyeshme. Gjuha standarde nuk duhet të jetë e limituar, përkundrazi ajo duhet të pasurohet

vazhdimisht nga dialektet e tjera me qëllim që të kemi një gjuhë të pavarur nga ndikimi i gjuhëve tjera.

Gjuhën shqipe nëse e shqyrtojmë dhe studiojmë me vëmendje do shohim se ajo është rrjedimishte shumë më e pasur sa që pasqyrohet në fjalorin e gjuhës së sotme. Sipas shkrimëtarit Vesel Nuhiu, “ Në mënyrë të veçantë duhet t’i qasemi pasurisë, laramisë dhe forcës shprehëse të leksikut e të frazeologjisë së krahinave të veriut, të cilat, qoftë në masën që na janë viksuar në veprat e autorëve që kanë shkruar në varietetin letrar të gegrishtes, qoftë edhe nga gurra e gjallë e gegërishtes së folur ose nga folklori i gegërishtes i veriut duhet vlersuar e vështuar kurdoherë si burime të freskisë dhe të prurjeve të domosdoshme për gjuhën letrare të përbashkët”.

Gjuha standarde duhet të merr parasysh hapjen e saj ndaj fjalëve të reja. Para së gjithash në kohët e fundit është vërejtur nevoja për pasurimin e gjuhës standarde, por duhet t’i kushtojmë një vëmendje të veçantë se çka po merret për të hyrë në leksikun e gjuhës tonë. Rëndësi të veçantë i është kushtuar nevojës që këto risi të jenë me bazë të pastër shqipe dhe jo të jenë huazime nga gjuhët e tjera, apo forma fjalësh të ndërtuara nga ne me ngjashmëri me gjuhët e tjera.

Tiparet e dialektit të veriut, përshembull, në leksikun e shqipes ku shihet se mund të gjejnë vend, sidoqoftë të natyrës së fjalëformit të gjuhës shqipe, duhet të integrohen në sistemin e gjuhës standarde, dhe strukturën e saj.

Nëse marrim parasysh leksikun krahinor dhe dialektor, shumë studiues paraqesin dhe mbrojnë mendimin që këto dialekte dhe fjalë, edhe pse mjaft të rralla në përdorim, edhe duke mos e marrë parasysh shtrirjen gjeografike, duhet të trajtohen si të barabarta. Vecimi i tyre dhe

etiketimi si fjalëlokale, krahinore, apo fjalë dialektore ndikon në mosinkuadrimin e tyre dhe të mos kenë status të njëjtë në gjuhën shqipe, që do ishte një humbje e madhe.

Përpjekje të shumta janë bërë në inkurajimin e popullatës që gjuha standarde të përdoret dhe të përvetsohet nga popullata e gjerë. Progres i dukshëm është arritur sa i përket gjuhës së shkruar. Kjo ka ndodhur edhe më shumë për arsye se pritët që të përdoret një gjuhë më akademike në të shkruar. Përvetësimi i standartes në gjuhën e folur ka hasur shumë ngecje dhe mungon vetëdijësimi i rëndësishëm që do kishte përdorimi i saj me efikasitet. Mospërvetësimi i gjuhës standarde në të folur vjen si pasojë e shmangies së standartes dhe tendencës për përdorimin e dialekteve të tyre.

Nëse shqyrtojmë dialektin e drenicës i vërejmë këto dukuri të shmangies nga gjuha standarde:

Shqipëtimi i *f*-se në vend të *h*-së kur ndodhet në fund të fjalës ose para bashkëtingëlloreve t dhe m: njof(njoh), ngrof (ngroh), njof (njoh) në gegërishten e Kosovës.

Pastaj edhe asimilimi i togjeve të bashkëtingëlloreve *mb, nd, ng*.

Poashtu një tipar karakteristik është mospërdorimi i *ë*-së fundore të patheksuar dhe zgjatja e zaonres së theksuar.

Një dallim tjetër është edhe përdorimi i *n*-së ndërzanore që është një tipar karakteristik i dialektit verior.

Prania e paskajores së tipit me punue dhe monofongimi i togjeve *ua, ue nëu*.

“Dialekti i Drenicës është një prej dialekteve më të folura në Kosovë dhe ndryshimet në shqiptim, të shkruar, dhe në rregullat gramatikore mbeten prej dëshmime kryesore që gjuha

shqipe përbën një laryshi shprehjesh dhe se ndikimi i popujve tjerë, që gjithmonë kanë sulmuar Drnicën të parën, ka lënë gjurmë të pashlyeshme në atë trevë malore me njerëz që kanë luftuar, si me armë, ashtu dhe me laps.”

Pra, mund të bazohemi në një hipotezë që mund të jetë e debatueshme por me mjaft mbështetje historike: *“Dialekti i Drenicës është mjaft dallues nga dialektet e tjera në Kosovëshkaku i ndikimit që ka pasur gjuha serbo-kroate, turke, si dhe ajo gjermane.”*

Gjuha gjermane, për shembull, ka ndikuar shumë në disa prej shprehjeve teknike që ende gjejmë përdorim në fjalorin e drenicasve. Këto fjalë, si përshembull ‘gepek’, ‘shteker’, ‘shtraf’, ‘benzin’, ‘shtapler’, etj., kanë ardhur si huazim nga qytetarët e Drenicës që kanë migruar në Gjermani qysh në vitet e gjashtëdhjeta. Sipas studiuesit Naser Pajaziti, në librin e tij *Shqipja standarde dhe dialektet*,

“Fillimisht gjatë mesjetës, ndërsa më vonë pas pushtimit të viseve shqiptare nga sllavët e jugut, gjuha shqipe ka qenë në presion të vazhdueshëm ndikimi nga gjuhët slave, vecmas nga serbishtja, e cila me anë të administratës e formave të tjera diskriminuese i është imponuar popullatës shqiptare. Si pasojë e këtyre rrethanave, në fjalorin e gjuhës shqipe kanë depërtuar një numër fjalësh nga gjuhët sllave.” (Pajaziti, 2015).

Si perfundim do ta përmbylлим me konstatim të prof. Gjovalit, i cili thotë:

“Dialektet dhe gjuha standarde, si variant i ngritur mbi bazën e një dialekti të së njëjtës gjuhë të përbashkët nuk janë dy ushtri kundërshtare që ndeshen për jetë vdekje dhe njëra shfaros tjetrën, por janë degëzime e nija të së njëjtës gjuhë, lindin e zhvillohen në të njëjtën bashkësi shoqërore, kanë lidhje të panumërta e te pashlyeshme si shprehëse të një

kulture të përbashkët, të një etnie të përbërë e të larmishme, porse kurdoherë të njëjtë dhe tëvetme”.

3.2 Disa veçori morfologjike të së folmes në Drenicë

Pozita gjeografike dhe popullsia.

Banorët e lokalitetit të Drenicës janë marrë dhe merren si edhe në të kaluarën, kryesisht me bujqësi e blegtori, ndonësesë edhe këto dy degë kryesore të veprimtarisë së tyre kanë mbetur mjaft prapa, në krahasim me kushtet e mira që ekzistojnë për zhvillimin e tyre. Toka këtu është më tepër kodrinore dhe jo shumë e plleshme për rritjen e grurit, misrit, tërshërës dhe të elbit, kultura kryesore këto me rritjen e të cilave merren banorët e kësaj ane; nga blegësia ata rritin më tepër gjedhët, si lopët, kuajt, mandej dhent etj.

Sipas regjistrimit të fundit, d.m.th. të vitit 1971, lokalitetin në fjalë e përbëjnë pjesën më të madhe banorët shqiptar: Broja numëron 1203 banorë (1180 shqiptar); Vojniku numëron 1275 banorë (1177 shqiptar), Kopiliqi i Epërm numëron 405 banorë (380 shqiptarë); Kopiliqi i Poshtëm numëron 770 banorë shqiptar dhe Turiçevci numëron 478 banorë (471 shqiptar). Banorët e këtyre fshatrave janë badqesh e fisesh të ndryshme : Gash (lagjet Marinovit, Kuçant dhe Hatalakt e fshatit Kopiliq i Epërm, Smajlovit e Kushtanët e fshatit Vojnik, Ramadazekët e fshatit Brojë, Mahalla e Gashit dhe Havollët e fshatit Kopiliq i Poshtëm); Krasniq (Hadrojt e fshatit Vojnik); Shalë (Shalaket e fshatit brojë Larojët dhe Hyskovit e fshatit Kopiliq i Poshtëm); Berishë (Lutantët e fshatit Turiçevc); Kelmend (Draga e Vojnikut); Kastrat (Gullbovcet e fshatit Brojë); Thaç (Ozdrimi i fshatit Vojnik); Duarakët (e fshatit Brojë), etj.

Banorët e këtij territory gjeografik, siç shihet edhe më lartë, janë familjesh e fisesh të ndryshme dhe ndërmjet këtyre vëllazërive e fiseve pothuaj nuk vërejmë ndonjë karakteristikë a tipar të ndryshëm të të folmes së tyre, me çka do të dallohej nga vëllazëria apo fisi tjetër. Kjo ka ndodhur kështu nga bashkëjetesa e gjatë midis tyre, bashkëjetese kjo që ka rrjedhën e vet prej dekadash dhe ka kushtëzuar doemos një rrafshim veçorish, një bashkësi pothuaj kompakte të kësaj të folmeje, e cila, siç do ta zëmë nëgojë më poshtë, nuk ndryshon shumë nga e folmja e Drenicës. Lidhjet kanë qenë përherë të ngushta ndërmjet këtyre banorëve; martesat i kanë bërë në të kaluarën e i bëjnë edhe sot midis tyre, por më rrallë brenda të të njetit fshat, në të shumtën e herës për shkak të kumbarisë së trashëguar.

Banorët e lokalitetit të Drenicës për treg më tepër shkonin në Pejë, në Mitrovicë e më pak në Vuçiternë (kazës së Vuçiternës i takonin gjithë fshatrat e lokalitetit të përmendur, me përjashtim të fshatit Vojnik, që i takonte kazës së Pëjës), ndërsa më vonë, pas çlirimit, banorët e Drenicës shkojnë për treg më tepër në qendra të vogëla komunale si në Skenderaj, në Klinë, e më pak në Istog dhe së këndejmi, na e merr mendja, duhen parë ndikimet në këtë të folme.

Për të folmen e lokalitetit të Drenicës, me përjashtim të një vështrimi të shkurtër mbi karakteristikat fonetike, nuk kemi të botuar ndonjë punim tjetër. Ndonjë studim i këtillë nuk është shkruar deri më tash as për të folmen e Drenicës (komuna e Skenderajit).

Është mbledhur në të vërtetë një material i pasur folklorik nga Anton Çeta, Halil Kajtazi dhe disa të tjerë; por të gjitha këto s'na kanë shërbyer për të nxjerrë veçoritë morfologjike të së folmes në shqyrtim, sepse materialet folklorike, si thotë dialektologja shqiptare Minella Totoni, kanë një adresë të pacaktuar dhe shërbejnë në radhë të parë si materiale folklorike, materiale të

dorës së dytë në krahasim me ato që gjurmohen në terren mu për çështje dialektologjike (Totoni, 1984).

Duke marrë këtë parasysh, kemi vepruar në këtë mënyrë: materialin për këtë punim e kemi mbledhur herë pas here nga persona kryesisht të vjetër, por për të parë tendencen e zhvillimit të gjuhës në të folmen tonë, kemi marrë ndër mend ndonjëherë edhe të folurit e brezit të ri. Këtë material e kemi mbledhur qoftë në bisedë të lirë, qoftë duke zgjatur këtë bisedë me tregime, përralla e anekdota, pasi ky terrior është mjaft i pasur me thesar të gurrës popullore, qoftë duke u ndalur në mikrotoponiminë e fshatrave, apo duke shënuar ndonjë material tjetër, frazeologjizma, etj.

Duhet thënë këtu gjithashtu se materialin e mbledhur e kemi verifikuar edhe një herë në terren, në mënyrë që veçoritë e kësaj të folmeje të na dalin sa më bindëse dhe të na japin pasqyrë sa më të qartë të këtyre veçorive. Duhet të përmendet gjithashtu se shumica e të dhënave më poshtë janë marrë nga libri “Dialektologjia Shqipe” e një grupi autorësh shqiptar, ndër të cilët edhe Idriz Ajeti. Sigurisht, ndryshimet e duhura dhe analiza të ndryshme janë bërë përgjatë këtij kapitulli.

3.3 Emri

Gjinia e emrit

Edhe në të folmen e lokalitetit të Drenicës, si në shumë të folme të tjera të gegërishtes verilindore, janë ruajtur tri gjinitë. Gjinia asnjëanëse, edhe pse e rrëgjuar prej kohësh, ruhet ende në këtë të folme.

Gjinia mashkullore

Janë të gjinisë mashkullore emrat që mbarojnë me k,g, të cilët kur shquhen marrin mbaresën shquese (nyjën e prapme)-u: mik-u, zog-u, plak-u, Sadik-u, axhak-u, kanak-u, sadak-u, hak-u, zog-u, shtog-u, lug-u, breg-u, prag-u, berllog-u, bun-u, cun-u, etj.

Emrat që mbarojnë me bashkëtingëlloren *h*, kur shquhen marrin mbaresën shquese-i: ah-i, thes-i, Salih-i, krah-i, rrah-i, sabah-i, Allah-i etj. Të gjinisë mashkullore janë edhe emra të tjerë që dalin me -n si frën-i, pën-i, sën-i, kofin-i, (për kufini), disa nga të cilët nëpër të folme të gegërishtes veriperëndimore dalin edhe në gjininë femërore si drûj-a, kanû-j-a, kufi-j-a-etj. Gjithashtu të

gjinisë mashkullore në këtë të folme janë edhe emrat e ashtuquajtur „mashkullorët e vjetër me -on”, të cilët në trajtën e pashquar dalin me ue a ū: krū- kroni, ftu- ftoni, prrū- prroni, thū- thoni, etj. Të gjinisë mashkullore na dalin edhe emrat lëndorë të tipit dyll-i, vjam-i, drith-i, mish-i, të cilët në gjininë mashkullore kanë hyrë nga gjinia asnjansë, d.m.th. këta emra janë dezintefruar në gjini.

Edhe emrat kā, vllā, dhē, shī, thī janë gjithashtu të gjinisë mashkullore dhe të shquar marrin nyjën e prapme- u: ka-u, vlla-u, shi-u, etj. Në disa të folme, kur shquhen këta emra dalin me një -v- epentike para mbaresës shquese -i: ka-v-i, vlla-v-i, shka-v-i, edhe v-I, shi-v-i, thi-v-i, dhe kjo është karakteristikë më së shumti për të folmet e Preshevës-Bujanovcit e të Moravës së Poshtme, por jo për të folmen tonë.

Ka edhe disa emra të tjerë të burimit turko-arab, që në trajtën e pashquar dalin me-i; ndërsa në të shquarën marrin mbaresën shquese (-j)a: Kadrī-j-a, Ali-j-a, Delī-j-a, Sejdī-j-a, Haxhī-j-a, etj.- Këtë (-j)a e marrin edhe disa emra që tregojnë profesion, mjeshtëri dhe emra të tjerë: furraxhī-j-a, apanxhī-j-a, sermagjī-j-a, kerraxhī-j-a, jabangjī-j-a, belagjī-j-a etj. Më në fund, të gjinis mashkullore janë edhe gjithë ata emra që sosin me bashkëtingëllore, e kur të shquhen, marrin mbaresën (nyjen shquese të prapme) -i: mal-i, lis-i, kal-i, djal-i, kerr-i, oborr-i, rrip-i, kingj-i, djep-i, dill-i, aksham-i, sabâh-i, etj.

Gjinia femërore

Të gjinisë femërore janë emërat që sot dalin **pa ë-në fundore** të tyre dhe rënia e së cilës ka shkaktuar zgjatjen e zanorës paraprise (si zgjatim kompensator): dārdha, ārr, zāll, tāll, mōll, bōll, lop, tok, buk, etj.

Emrat e këtillë, kur shquhen, marrin mbaresën shquese -a. Në këtë rast zanorja paraprise e saj nuk është më e gjatë, por e mesme, apo më mirë të themi, është gjysëm e gjatë. Emrat e tipit fë, bē, dhe ata që mbarojnë me të folmen tonë me ê hundore si janë belê, kalê, rixhê (belá, kalé, rixhá), kur të shquhen marrin para mbaresës shquese -a edhe një -i- antihiatizues: kalê-j-a, belê-j-a, rixhê-j-a, e murr vesh dyjêja.

Janë femërorë gjithashtu emrat që mbarojnë me e-në e patheksuar në fund të fjalës dhe këta kur shquhen marrin një -j- antihiatizuese para mbaresës shquese -a: delme-j-a, nus-j-a, xhad-j-a, teneç-j-a, hajgar-j-a, batar-j-a. Me (-j-) a mbarojnë po kështu edhe disa emra të tjerë të cilët në të pashquarën sosin me zanorën i te thrksuar: shpī-j-a, kuī-j-a, kamxhī-j-a, turshī-j-a, budallakī-j-a, ahmakī-j-a, etj. Me emrat e fundit do të shkonin edhe pak emra të tjerë, të cilët pernga kuptimi janë emra kolektivë si çabanī-j-a, argatshtī-j-a, mahallī-j-a, por në këtë të folme emrat përmbledhës granī-j-a, burrnī-j-a, dalin, kur të shquhen me prapashtesën -im dhe mbaresën shquese -i: granim-i, burrnim-i, djelnim-i etj.

Gjinia asnjënëse

Siç e kemi përmendur edhe më parë kjo gjini sa vjen e dezintegrohet dhe emrat lëndorë të tipit dyll, vjam, mish, drith, të cilët, më parë ishin emra thjesht asnjënës, dhe ashtu, siç na dëshmojnë edhe veprat e shkrimtarëve të vjetër të shek. XVI-XVII, mbaronin me mbaresën shquese -t ose të në këtë të folme, assht siç ka ndodhur më në fund edhe më shumë të folme të tjera të gegërishtes, kanë kaluar në gjininë mashkullore, disa nga të cilët u përmendën edhe më sipër, marrin edhe mbaresën shquese -i: dyll-i, vjam-i, mish-i, drith-i, bark-i (brezi i ri), vorrr-i, faj-i, ndërsa emrat uj-t, xhi-t, mill-t, përdoren edhe si emra të gjinisë mashkullore: uj-i, xhin-i, mill-i, ashtu siç e ka vërejtur Latif Mulaku për të folmen e Shalës së Bajgorës.

Edhe emrat flaka, krypa, buka êna kanë ndërruar gjininë, sepse në krye të herës këta ishin emëra të gjinës asnjane. Të gjinisë asnjane sot kanë mbetur në të folmen e lokalitetit të Turiçevcit vetëm disa emra të substantivuar prej mbiemrash apo prej foljesh: t kuçt e vōs, t zīt e thonit, t hollt, t trasht, t premt, t shēm, t’hant, t, nrejtit, t xhânt, (t kuçt, t zī-t, t hōll-t, t trasht, t prēm-t, t nēm-t, t shtrem-t, t han-t etj.

Emrat e këtij tipi, siç dihet, në shqipen letrare që nga periudha e Rilindjes e këndej kanë ardhur duke u përdorur dendur me prapashtesat: -je, -si, -im, p.sh. bajtje, ardhje, prerje, blerje, hollësi, trashësi, gjerësi, drejtim (nrejtim), zgjerim (zgjanim). Të gjinisë asnjane në këtë të folme e gjejmë gjithashtu emrin krý-t. Ky emër në rasat e zhdrejta del i gjinisë femërore, siç dëshmojnë shembujt; i rash krēs, ma nxhii dhimta e krēse, po t bika krēs, me t ra krēs, etj. Duhet theksuar që shumë emra ndonëse përnga trajtat (mbaresat), janë të gjinisë mashkullore apo femërore, në të folmen tonë si edhe në të folmen e Shalës së Bajgoreës, fjalët përcaktuese të tyre (mbiemrat, përemrat, dhe emërat në rasën gjinore) e ruajnë ende gjininë asnjane: kta krýp t love, kta pleh t xhâve, kta buk t argatve, piva ūj të ftoft, haṅgra mjâlt t bletve, kta â dhē t kuç, kta â mill t gryt, etj.

Kur jemi te gjinia e emrave, atëhere s’duhet lënë pa u përmendur edhe disa emra, të cilët nëpër të folme të gegërishtes së veriperëndimit që të gjithë janë të gjinisë femërore, ndërsa në të folmen tonë na dalin, në pjesën më të madhe, të gjinisë mashkullore: djepi, loti, borçi, fruthi, bruni, kalli, lixhi, shorti, kanuni. Në të folmen tonë janë të gjinisë femërore gramatikore emrat shneta, flaka, nera, libra.

Disa emra të tjerë dëgjohen herë si emra të gjinisë mashkullore, e herë të gjinisë femërore: pasuli edhe pasula: vjet e na bini pasula, zalli edhe zalla: â dal zalla mīr; sēj edhe saj-a: thmijve u

marojsha saja; úni edhe ûja: m paska mârr ûja. Po kështu s’do lëmë pa përmendur këtu edhe një fenomen: ndërrimin e gjinisë së disa emrave në gjuhën shqipe.

Kjo karakteristikë, e cila i ka përfshirë edhe gjithë të folmet e shqipes, e kjo s’ka pasur pse të mos ndodhte edhe në të folmen tonë, është një dukuri relativisht e vjetër në gjuhën shqipe, një tendencë për të zhdukur që herët “vijën e kufirit” ndërmjet atyre emrave që emërtojnë jofrymorë - është përhapur edhe në të folmen e Drenicës. E ndërrojnë gjininë në shumës disa emra jofrymorë që në shumës dalin me mbaresën -e (-īe) dhe disa të tjerë që në zanafillë kanë qenë asnjans: kto vëne, vëne t’mira, malī-e t’nâlta, vneshti-e t’mira, etj.

3.4 Shumësi i emrave

Edhe në formimin e numrit shumës, siç do ta shohim më poshtë, e folmja e Drenicës nuk dallon shumë nga të folmet e Shalës së Bajgorës, të Preshevës – Bujanovcit, të Moravës së poshtme, nga e folmja e Kastratit, e Lugut të Drinit të Bardhë dhe nga disa të folme të tjera të gegërishtes verilindore.

Në këtë pikë thuajse kemi një unitet dialektor midis mëtyre të folmeve, të cilat si të folme të një nëngrupi të përbashkët dialektor, kanë edhe shumë pikëpërkime të tjera dialektore. Emrat mashkullorë, siç dihet, numrin shumës e formojnë në mënyrë mjaft të larmishme, ndërsa kjo më pak vlenë për emrat e gjinisë femërore.

Me mbaresën e shumësit -a e formojnë numrin shumës në të folmen tonë një shumicë emrash: plep-a, gisht-a, grusht-a, xhep-a, brryl-a, drun-a, matorr-a, daktorr-a, bisht-a, nushân-a, insân-a, etj. E marrin këtë mbaresë edhe disa emra të kafshëve që në trajtën e pashquar mbarojnë

me -an dhe emra të tjerë pejorativë që mbarojnë në njëjës gjithashtu me -an: golan-a, sykan-a, rudan-a, djel lazdran-a, shtincan-a, etj.

Emrat mashkullorë që mbarojnë me varet k, g i qiellëzorzojnë këto në fund të fjalëve në ç dhe gj, ku q dhe gj në të folmen tonë janë kthyer në afrikate në ç dhe xh: miç, fturç, (edhe tfurçi), turç (edhe turçi), dyrek – dyreq, pllug - pluxh, lug – luxh, etj. Ndonjë nga emrat e shënuar më lartë merr edhe mbaresën e shumësit -e: dushç-e, barç-e, xhaç-e, kryq-e, tapraç-e, etj. Por disa emra të tjerë, e këta sa vijnë e shtohen, edhe pse mbarojnë me bashkëtingëlloret e përmendura k, g, nuk i palatalizojnë këto në q dhe gj (ç dhe xh) as nuk marrin mbaresën -e, por marrin mbaresën e shumësit -a: kapak-a (edhe kapāk), sanak-a (edhe sanāk), axhak-a (edhe axhāk).

Po kështu, me anë të palatalizimit e formojnë numrin shumë edhe disa emra të tjerë, të cilët në trajtën e pashquar përfundojnë me bashkëtinglloren -ll, në numrin shumë e palatalizojnë këtë në -j: buj, kunuj, krymyj, karcej, mashkuj; por fyll-a, kavall-a, petull-a (për analogji me emrat e gjinisë femërore kumll-a, petull-a, etj).

Te shembujt e mësipërm breg-a, shtog-a, sanak-a, kapak-a, kavall-a, shihet një tendencë e qartë drejt nivelizimit të trajtave dhe zëvendësimit të një mbarese me një tjetër më shprehëse, kur ata emra dalin pa ndonjë mbarese.

Kjo dukuri vërehet më së shumti në të folmen e Drenicës. Me metafoji formojnë shumësin emrat: desh, sjep, tereç, mzet, pleq, bineç, kuleç, etj. Shumësi i emrave të gjinisë femërore – Emrat e gjinisë femërore e formojnë shumësin më së shpeshti duke I ngjitur temës së njëjësit mbaresën -a: moll-a, arr-a, dardh-a, thêmr-a, kunr-a, zemr-a, etj. – Ata emra të kësaj gjinie që mbarojnë me -I të theksuar, në numrin shumë para mbaresës -a marrin edhe një -j: shpi-j-a, kusi-j-a, etj.

3.5 Rasat

3.5.1 Rasa kallëzore

Emrat mashkullore që mbarojnë me bashkëtingëllore formojnë rasën kallëzore duke marrë para mbaresës -n edhe një -i- ose -u-: djal-i-n, kal-i-n, mal-i-n, etj. Po në kë të mënyrë e formojnë rasën kallëzore edhe emrat që në njëjës të pashquar mbarojnë me ū (ue) ose me zanoren hundore: kronin, ftonin, pênin, hûnin, etj.

Emrat e gjinisë mashkullore që në emroren e pashquar mbarojnë me zanoret e theksuara a, e, dhe I, në rasën kallëzore marrin një -u- para mbaresës -n; vlla -u -n, ka -u -n, dhe -u -n, thi -u -n. Por disa emra të tjerë kafshësh, p.sh. baloj, sivoj, luloj, pllavoj, e formojnë rasën kallëzore drejtpërdrejt pa e marrë ndonjë tingull tjetër para mbaresës -n: balojnë, sivojnë, lulojnë, pllavojnë, etj. Krejt njësoj si në të folmen e Kastratit.

3.5.2 Rasa thirrore

E ashtuquajtura deri tash si thirrore, tash e tutje do të njihet si rasë emrore. Përdoret shpeshherë në këtë të folme kur dikush i drejtohet dikujt, e thërret dikë për diçka. Emrat në rasën e ashtuquajtur thirrore apo në rasën emrore përdoren të shumtën të shoqëruar me -o, p.sh. more, kur janë të gjinisë mashkullore; dhe -oj, p.sh. moj, mori, kur janë të gjinisë femërore, p.sh.: o Smajl, o Smajlo (ndonjëherë pjesëza -o u prapangjitet emrave në këtë rasë); O Miftar, hajde more khâ kah na; oj Sadi mule dhêt nâr; oj gru (e) bina qata bukë; Hajde more nuse, ec ma shpejt, etj.

Por jo rrallë e ndeshim këtë rasë të përdorur edhe pa asnjë pjesëz: Smajl!; Mehmet!; Sadi!; Çun mos shko anej!; Ndonjëherë pjesëzave të përmendura o, oj, more, mori, u prinë edhe pasthirrmat (h)ej, ej, kur duam dikujt t’I tërheqim vëmendjen ose t’i flasim me përzemërsi; hej o ti njeri, hej more djalë, ça ki që po gutesh?, ej moj, hajde ma shpejt.

3.5.3 Rasa rrjedhore

Kjo rasë, siq ngjanë edhe në gjithë të folmet e gegërishtes verilindore, në njëjës, te emrat e gjinisë femërore del me të njëjtën formë për rasat rrjedhore dhe dhanore, e konkretisht në të folmen tonë del me mbaresën, s, a, - es: pej nans (edhe pej nanes), pej qiks (edhe pej qikes), pej ders (edhe pej deres), etj.

Por, në disa të folme të tjera veriperëndimore kjo rasë formohet nga trajta e saj e pashquar me mbaresën -et, ku -t nuk është gjë tjetër veçse një shtesë mekanike që I është ngjitur në krye të herës trajtes së pashquar të rrjedhores: mish delmet, mish lopet, mish dhiet (në të folmen tonë mish t delmes, mish t lopes, mish t dhis).

Po kështu me -et në këto të folme dalin edhe disa emra me parafjalët që kërkojnë rasën rrjedhore: perpara babet, pej Zadrimet, pej Shkodret, pej Toket (në të folmen e Drenicës do të bënte perpara babs, pej Zadrimës, pej Shkodres, pej Tokes). Rasa rrjedhore e shquar shumës -shit (sh – i – t) sot ruhet vetëm në veprat e shkrimtarve të vjetër shqiptar dhe në të folmet arkaike të Arbëreshëve e nuk dimë të jetë ruajtur në ndonjë të folme tjetër; ajo që prej kohës është zëvendësuar nga forma e dhanores së shquar shumës, e cila, siq e dimë, gjithnjë ka ardhur duke u përdorur pa mbaresën -t, dmth, në trajtën e pashquar.

Megjithëkëtë, ndoshta për analogji, mbaresën e rrjedhore së shquar shumës – sh- i – t ose gjurmët e saj ende i gjejmë në këtë të folme, si edhe në të folmen e Shalës së Bajgores. Disa nga ndajfoljet si: aty (qaty), ktu (qitu), ku (kur), dje, pardje, në rasën rrjedhore zgjerojnë me – shit dhe – it: pej atyshit (atyhit), pej ktushit (pej ktuhit, pej qituhit). Edhe rasën e pashquar rrjedhore në numrin shumës me -sh në këtë të folme e gjejmë tepër rrallë, meqë në vend të saj përdoret rasa gjinore me nyjen e përparmen -t(të): fjalë të burrav(e), punë të grav(e), lesh dhene, lang t specav(e), thelba të arrav(e), etj.

Në fund, duke përfunduar për rasën rrjedhore dhe përdorimin e saj në këtë të folme vetëm do ta shtonim se aty e gjejmë këtu ndonjëherë edhe në vend të rasës emrore e kallëzore, p.sh., po shkoj pej shpie(=po shkoj tu shpia); po shkoj pej shehri(t) (=po bi në shehër); po shkoj pej arav(e) (=po shkoj tu arat), etj.

3.5.4 Nyja

3.5.5 Nyja e trajtës së pashquar

Nyja e trajtës së pashquar *nja* për dallim nga numërori **themelor *nja* prej të cilit ka dalë, të shumtën** e herave ka evoluar në n(i): u ka ni(i) njeri ; e gjeta ni(i) sen; u bana me i njeri; e zateta i coban etj.

Nyja *nja* ka evoluar në-j kur bashkëshqiptohet me ndonjë fjalë tjetër paraprise që mbaron me ndonjë zanore të theksuar: jav kum ba me tybe; mi gjet najsen: pum (për po m) duhet me shku(e); duhet me met pa ta najhere, etj.

3.5.6 Nyja e përparme

Elidimin e nyjes së përparme, siç e kemi thënë më parë e hasim shpesh në këtë të folme. Kështu elidohet nyja e përparme në fjalët: djali keq, buka bardh, gishti gat, seni kec, djali mirë, djali ti, etj.

Elidimin e nyjes së përparme e gjejmë gati rregullisht në mikrotoponimet e këtij lokaliteti: Kodra Madhe, Ara Ukës, Lluga Bunarit, Shpati Shkive, Prroni Vjosav, etj. Por nuk elidohet nyja e përparme e këtyre mikrotoponimeve saher që elementi i parë i tyre përfundon me nyjen e prapme –u ose është në numrin shumës: Bregu i Haparit, Cungu i Zi, Anrat e Hotve, Arat e Rrafshëve, Llazet e Beganve, etj.

Një karakteristikë tjetër që do përmendur në këtë mes është edhe zëvendësimi i nyjes së përparme s(së) në t(të) (ju ngjitsha kodres t madhe; i thojshna qikës t vogel), karakteristik kjo jo vetëm për të folmen tonë në rajonin e Drenicës, por edhe për disa të folme të gegërishtes.

Nyja s(së) e konglutinuar në këtë të folme na del vetëm në një fjalë –sames.

Nga emrat farefisor të vjeter me një të përparme dalin në këtë të folme emrat: e ama, i biri, i shoj (por I shoqi), dhe I vlla(edhe vllau). Me një të përparme gjithashtu dalin në t folmen tonë

disa emra të tjerë që tregojnë anas, banorë të një vendi, të një lagjeje, të një katundi a të një krahine p.sh. cohet i brojsi e i bjen mrena t koplicsit, vec me dhanë ciken; koka kan shku zaher i llaushsi te ai klinsi; kokan kap diçka ner mje veti i vojksi me t izbicsin, etj.

3.5.7 Nyja e prapme

Emrat e gjinisë mashkullore që mbarojnë me velaret k,g, siç e kemi përmendur në fillim të punimit tonë, kur të shquhen marrin të ashtuquajturën deri këtu në traditën gramatikore nyjë të prapme –u, duke përjashtuar këtu brezin e ri që si novacion ka pëlqyer për këtë rast termin mbarese shquese –i: zheg-u, breg-u, zog-u. prag-u, dushk-u: ndërsa te brezi i ri dhe mëi ri këto fjalëi dëgjojmë të shquptohen me mbarese –i: zheg-i, breg-i, zog-i, prag-i, dushk-i, etj.

3.6 Mbiemri

Edhe për të folmen në shqyrtim është karakteristike formimi i mbiemrave nga pjesorja e vjetër me –un: i djegun, i pjekun, i lanun, i dalun, i koritun, etj.

Përdoren shumë edhe mbiemrat cilësorë të formuara nga pjesorja dhe ndajfolja me prapashtesat –n dhe –t: i len, i pren, i nxen, i vran, i ftoft, i ritaft, i ngrit, etj.

3.7 Numërori

Numërori nja përdoret njësojë si në rasën emërore ashtu edhe në rasën kallëzore p.sh.: nja erdh prej qatjehit, nja pej qitanshit, nja shkon ma cpejt, etj.

Numëroret dy, tre dallohen sipas gjinisë së emrit afër të cilit rrinë dhe nga gjatësia fonologjike e zanors së numërorit; janë të gjinisë mashkullore numëroret me gjtësi të shkurtur, ndërsa numërorët e gjinisë femërore kanë gjatësi të gjatë të zanores së tyre p.sh.: tre desh e tri dhen, tri lop e tre kual, etj.

3.8 Ndajfolja

Ndajfoljet e vendit: ktu(qitu) knej(qeknej), knena(qiknenea), anej, anena(qanena), atje(qatje), ksajde(qesajde), dika(h), kerka(h), etj.

Ndajfoljet e kohës: tash-ti(qitash-ti), sod, dje, pardje, partjetridje, nesra, masnesra, santé, pramna, vjet, parvjet, etj.

Ndajfoljet e mënyres: kshtu(qishtu), kecas, burrnisht, hajnisht, budallakisht, etj. Në këtë të folmei ndeshim shpeshherë edhe këto ndajfolje të mënyrës, diqysh, kurrqysh, kec, ashtu,

Ndajfoljet e sasisë: shumë, pak, qikac, qaq, sa qikjo, sa qajo, sa qita, boll shumë, boll pak, etj

3.8 Parafjala

Me rasën emërore përdoren parafjalët: tu, te, ka p.sh. po shkoj tu dajt, po shkoj tu kroni, po shkoj te gjaja, po nalna kah ju, pod al kah mali, etj.

Me rasën kallëzore shkojnë parafjalët: në, ner, ndërsa me rasën rrjedhore përdoren paafjalët dhe ndajfoljet e parafjalëzuara: pej shpis, pej ars, rreth aborrit, karrshi lams, skej livadhit, akolla

shpis, etj. Gjithashtu me rasën rrjedhore përdoren edhe disa parafjalë me burim ndajfoljor: ngat, larg, jasht(a) etj.

3.9 Lidhëza

Si lidhëza bashkërenditëse përdoren no...no; ja...ja; nash...nash, p.sh. no mere qeta, no mos merr kurgja; ja punoe mirë, ja mos ja nis hiç asaj pune; nash hajde me neve, nash shko me ta, ham livdohesh, ham s je kërkushi etj.

Lidhëzat nënrenditëse më të përdorura janë: n koft qi, masi, kur, edhe qi, edhe se, etj.; n koft që s vje me neve, bile kallxona; masi s munesh me ardh mos hajde; kur t erdhen ment, hupen dhet; edhe se shkun, nuk jav pau kush hajrin etj.

3.10 Pjesëza

Pjesëzat i gjejmë sidomos në rasën thirrore: a, more (përemrat e gjinisë mashkullore) oj, moj , mori, (përemrat e gjinisë femërore): o Vesel, more djal, oj Sadi, oj cikë, mori bij, etj.

Përdoren gjithashtu pjesëzat mohuese: mos hajde, mos shko, nuk muj, nuk du; nuk dal, coll sot. Ndërsa pjesëzat e pohimit që përdoren me së tepërmi janë: ani, ani mire, ani mire de, po, pode, po qysh, po qysh de, etj.

3.11 Fjalëformimi

Nëse e vështrojmë të fomen e lokalitetit të Drenicës, atëhere mund të konstatohet lehtë se tipi më produktiv i fjalëformit në këtë të folme, siç ngjan edhe me shumë të folme të tjera, është formimi afiksial me prapashtesa.

3.12 Parashtesat

Sa i takon parashtesave, duhet thënë se numri i tyre është dukshëm më i vogël në krahasim me numrin e prapashtesave i cili është mjaft i larmishëm në këtë të folme. Këtu po i përmendim parashtesat që i gjejmë më së tepërmi në gojën e shqipfolësëve të kësaj ane: c-: (m i)ckoklu (c + kokërr), (c palu) (khs. Palu), (m i) çkarku (khs.ngarku), u clesh (c+ lesh) etj. Pos parashtesave edhe prapashtesave në këtë të folme vërejmë edhe tipin tjetër të fjalëformit, fjalëformimin morfologjik afiksial: di-t-a, pa-t-a, shi-t-a, ly-p-a, etj.

Kapitulli i katërt

4.1 Studim hulumtues dhe statistikor i të folmes në Drenicë

Në këtë kapitull një dizajn kërkimor i hartuar me një bashkëlidhje metodash moderne hulumtuese do të jëtë një prej objektivave që do të na përcjellin deri te materiali bazë që do të na mundësoj, potencialisht, të kuptojmë prejardhjen ndryshuese të dialektit në Drenicë.

Një prej objektivave më të rëndësishme do të jetë gjetja e disa të dhënave që lidhen drejtpërdrejtë me ndryshimet gjuhësore mes gjeneratave të vjetra dhe atyre më të reja. Kjo, sigurisht, është arritur nga një formulim i një pyetësoi që u është ofruar dy grupeve të mëdha ndividesh që banojnë në Drenicë por që u përkasin moshave të ndryshme.


Njëri grup përbëhet nga persona mbi 60 vjeçar, ndërsa tjetri prej atyrenën moshën 18 vjeçare.

Pyetjet hulumtuese do të jenë si në vijim:

- Pse mendoni se ndryshon dialekti juaj me atë të vendeve tjera në Kosovë?
- A hasni në keqkuptime gjatë të folurit me ndonjë person të ndonjë komune tjetër?
- A hasni në keqkuptime kur flisni me persona më të moshuar se ju?
- A mendoni se ka ndryshuar dialekti i të folurit tuaj nga koha kur keni qenë fëmijë?
- Kush mban përgjegjësinë kryesore për ndryshimet gjuhësore moderne?
- Cilat janë disa prej fjalëve të cilat nuk janë kuptuar nga shokët apo shoqet e juaja në komunat e tjera jashtë Drenicës?
- A e gjeni të vështirë që të lexoni dhe të kuptoni gjuhën e shkruar nga poetët si Naim Frashëri, Ndre Mjeda, Migjeni, dhe Asdreni?
- A e gjeni të vështirë të lexoni dhe të kuptoni prozën e Marin Barletit, Gjon Buzukut, apo Gjergj Fishtës?
- Sa e vështirë ju duket gjuha e sotme shqipe që flitet në media (agjensi të lajmeve, muzikë, film, etj.)?
- Sa prej këtyre fjalëve i njihni (gujë, kapixhik, laknur, vinjak, xhybe, çitap, çardak, dyrek, minik, tangar, kashore, fllanik, shosh, bitis, etj.)?

Ky popullacion është mjaft i madh ashtu që të na e mundësoj të bëjmë pergjithësime dhe të nxjerrim përfundime të sakta mbi dialektin e Dreincës dhe ndryshimet që kanë ndodhur dhe po pasojnë dita-ditës. Me poshtëdo të gjenistatistikat e nxjerra përmes figurave dhe të shpjeguara detajisht.

1. Pse mendoni se ndryshon dialekti juaj me atë të komunave tjera të Kosovës?




Ndryshimet në dialektin e Drenicës kanë ardhur si rrjedhojë e migracionit të popullësisë së kësaj treve nëpër rajone të tjera të Kosovës si dhe në vende të tjera jashtë saj. Në figurën më lart është paraqitur në mënyrën statistikore mendimi i qytetarëve të Drenicës, që u takojnë moshave të ndryshme, në raport me pyetjen se pse dialekti i tyre ka aq shume dallime me trevat e tjera të Kosovës.

Numri më i madh i banorëve mendojnë se kjo është shkaktuar nga migrimi i hershëm i Drenicakëve në Turqi dhe Gjermani.

Një numër i banorëve mendojnë se ndryshimet dialektore kanë ardhë si rrjedhojë e profesionit primar që e kanë pasur banorët e kësaj treve, pra marrjen e tyre me bujqësi. Prandaj, përshembull, dialekti i tyre dallon me atë të gjakovarëve të cilët janë marrë më shumë me tregti.


Një tjetër supozim vjen nga një numër të rinjsh të cilët mendojnë se dialekti i tyre është i ndryshëm nga roli që ka luajtur letërsia në jetën moderne. Në lidhje me letërsinë do të flitet edhe më gjërë në figurat në vijim.



Edhe pse Kosova njihet për një numër goxha të madh të dialekteve, sidomos duke konsideruar numrin e vogël të popullsisë dhe sipërfaqen e vogël territorial, banorët e këtij vendi prap se prap kuptohen mjaft mirë me njëri tjetrin.


Ne njohim shumë raste kur banorët brenda për brenda një shteti flasin të njëjtën gjuhë por me aq shumë dallime dialektore sa që është pothuajse e pamundur të kuptojnë njëri-tjetrin. Një rast si ky mundë të konsiderohet Anglia. Ne në Kosovë, për dallim, edhe pse kemi ca ndryshime prapë se prapë kuptohemi mirë.

Këtë më së miri e shfaqë figura më lart e cila paraqet figurativisht këtë detaj. Nga njëqindë (100) persona të cilëve ju kemi shtruar pyetjen se a e kanë të vështirë ti kuptojnë qytetarët e rajoneve të tjera të Kosovës 81% e tyre jnaë shprehur se nuk e kanë të vështirë ti kuptojnë të tjerët. Ndër ta vetëm 13% kanë thënë se kanë shumë problem në këtë aspekt.



Ndryshimet dialektore, ashtu siç e kemi vërejtur në kapitujt e mëparshëm shfaqen më së shpeshti kur bëhet dallimi mes të folurit së një të moshuari dhe një të riu. Të moshuarit në përgjithësi kanë tendencë më të madhe që të përdorin fjalë me prejardhje sllave dhe turke, ndërsa të rinjtë janë më të prirur që të flasin dhe të shkruajnë në gjuhën standarde dhe duke përdorur fjalë me prejardhje nga anglishtja apo gjermanishtja.

Gjithashtu, përveq zgjedhjeve leksikore vërehet edhe dallimi fonologjik i zanores ‘o’ si për shembull: të moshuarit thonë “çka po ban?” ndërsa të rinjtë, shkakut i ndikimit të dialektit që flitet në kryeqytet, zanoren ‘a’ e shndërrojnë në ‘o’, pra, “qka po bon?”.



Në grafikun e paraqitur më lart është paraqitur statistikisht vetëvlersimi i banorëve të Drenicës rreth dialektit të cilin e flasin dhe ndryshimet që ky dialekt i ka pësuar gjatë viteve.

Një fakt interesant është se shumica e personave të intervistuar që i takonin një moshe më madhore pra 40 deri në 70 vjeç ishin të bindur se dialekti i tyre nuk kishte ndryshuar fare nga koha kur kishin qenë fëmijë. Ndërsa të rinjtë, në anën tjetër theksonin se e folmja e tyre kishte ndryshuar nga koha kur kishin qenë nxënës të shkollës fillore dhe të mesme, pra sa ishin ende duke jetuar dhe vepruar brenda territorit të Drenicës.


Të gjithë ata që ose kishin migruar jashtë vendit apo atyre që i vijonin studimet në Prishtinë u kishte ndërruar sado pak fjalori dhe dialekti të cilin e flisnin më parë.

5. Cilat janë disa prej fjalëve të cilat nuk janë kuptuar nga shokët apo shoqet e juaja në komunat e tjera jashtë Drenicës?

Kësaj pyetje të cilën ua kemi shtruar një numri prej njëqind gjimnazistëve dhe studentëve nga Drenica i janë përgjigjur afro gjashtëdhjetë prej tyre. Ndër fjalët më të shpeshta të cilat i kanë përmendur në lidhje me këtë pyetje janë:

- Llaze, që në dialektin e Drenicës del me kuptimin fushë, livadh.
- Kauçuk, që në Drenicë përdoret si sinonim i fjalës plastik. Shumë prej këtyre të intervistuarve nuk kanë hezituuar të shtojnë se bashkëbiseduesit e tyre, edhe pse të hutuar në fillim, më vonë ishin shprehur se një version i kësaj fjale gjendej edhe në dialektin e tyre, përshembull fjala ‘kallçuk’ në Moravën e Epërme.
- Bub, që në Drenicë përdoret si fjalë përkdhelëse për një këlysh të vogël.
- Qylym, që i bie tepih, shtrojë.
- Halet, që te ne del me kuptimin mjet pune, vegël.
- Pekmez, që në Drenicë është një lloj xhemi i prodhuar nga lëngu i valuar i dardhave.
- i,e ritavt, që në të folmen e Drenicës del si mbiemër që nënkupton diçka të lagësht.

6. A e gjeni të vështirë që të lexoni dhe të kuptoni gjuhën e shkruar nga poetët si Naim Frashëri, Ndre Mjeda, Migjeni, dhe Asdreni?



Në figurën e parë është përmendur se një ndër arsyt kryesore pse gjuha shqipe ka kaq shumë variacione është roli që luan dhe ka luajtur letërsia.

Për të verifikuar ngjashmëritë dhe dallimet mes gjuhës në të cilën shkruanin autorët dhe poetët e mirënjohur shqiptar të rilindjes me dialektin që flitet sot në Drenicë popullacionit të këtij studimi i janë ofruar disa fjali dhe vargje të Naim Frashërit, Migjenit, dhe Asdrenit. Këto vargje dhe fjali janë si në vijim:

*O malet' e Shqipërisë e ju o lisat' e gjatë!
 Fushat e gjëra me lule, q'u kam ndër mënt dit' e natë!
 Ju bregore bukuroshe e ju lumenjt' e kulluar!
 Çuka, kodra, brinja, gërxhe dhe pylle të gjelbëruar!
 Do të këndonj bagëtinë që mbani ju e ushqeni,
 O vendëthit e bekuar, ju mëndjen ma dëfreni.*

Këto vargje të njohura për të gjithë shqiptarët për nga gjuha janë shumë të ngjashme me të folurit e sotëm në rajonin e Drenicës. Pra shumica e të intervistuarve nuk kanë hasur në asnjë pengesë gjatë leximit të këtyre rreshtave.

Disa prej ndryshimeve të vogëla janë si për shembull: shqipërisë-shqipnisë, gjatë-gat, gjëra-gjana. Ndërsa për nga ngjashmëritë bie në sy për shembull pjesëza në rasën thirrore ‘O’, p.sh ‘o malet’, ‘o lisat’, etj. Kjo pjesëz është mjaft e popullarizuar në të folmen e Drenicës.

Njësoj mund të thuhet për ngjashmëritë dhe dallimet mes letrave të Asdrenit dhe të folmes së Drenicës. Të intervistuarve i është kërkuar t’i lexojnë këta rreshta:

*Kur të pashë me s’të lashë,
T’u afrova e s’tu ndashë
Dhe me zë t’ëmbël të thashë:
“Sa të dua o moj vashë!”*

Nga këto vargje është mjaft intetsant të vërejmë foljen afrova e cila del me zanoren ‘a’ në vend të zanores ‘o’, pra afrova në vend të ofrova e cila shpesh di të jetë variacion në të folmen e Llapit me rrethinë duke përfshirë Prishtinën, edhe pse, faktikisht, foljet afroj dhe ofroj kanë kuptime të ndyshme.

Ndër të tjera edhe këtu vërhet pjesëza në rasën thirrore ‘o’ dhe ‘moj’ si në vargun “*Sa të dua o moj vashë!*” që është mjaft e përdoruar në të folmen tonë.


Në figuracionin e paraqitur më lart përqindjet e dala nga intervista me njëqind të intervistuarit në Drenicë na dalin se 94% e tyre nuk hasin në asnjë problem gjuhësor gjatë leximit të këtyre shkrimeve.

Një prej arsyeve mund të jetë edhe ngjashmëria e madhe mes dialektit të Drenicës dhe të Shkodrës në Shqipëri siq edhe është përmendur më herët në këtë punim. Në anën tjetër vetëm 6% e tyre janë shprehur se kanë hasur nëshumëpak vëshirësi në të lexuarit e këtyre shkrimeve.

Popullacionit në fjalë i janë ofruar edhe vargje nga poetë dhe shkrimtarë të tjerë. Rezultatet kanë dalë të njëjta, prandaj edhe nuk janë cekur në punim.

7. A e gjeni të vështirë të lexoni dhe të kuptoni prozën e Gjon Buzikut dhe Pjetër Bogdanit?

■ Po ■ Jo ■ Pak



Si vazhdimësi e pyetjes paraprake kemi menduar se do të ishte interesante të analizojmë dhe verifikojmë ngjajshmëritë dhe ndryshimet mes të folmes së Drenicës dhe prozës së hershme shqipe nga autorët si Buzuku dhe Bogdani.

Të intervistuarve u është ofruar nga një fjali nga të tre autorët. Përgjigjet e tyre se sa është e vështirë për ta që t'i kuptojnë këto fjali janë mjaft interesante. Së pari po i cekim fjalitë që u janë ofruar:

1. *“gjuha jonë nukë kish gjaa të endigluem en sëh shkruomit shenjtë”* (Buzuku).

2. *Cezar Augusti “Dëshironte fort me pasun ndë ushtritë tinë t’arbëreshëtë. Përse thonj pësonjënë shumë e nuk druhen për hu e për het, se janë më zemërorë se të tjerëtë”* (Bogdani).

Banorët e Drenicës, edhe pse me mjaft vështirësi, prapë se prapë arritin që t'i kuptojnë fjalitë më lart. Në fjalinë e parë Buzuku shprehej se në gjuhën shqipe asgjë që ishte e predikuar nuk ishte e shkruar, që ishte edhe aryeja kryesore pse ai ndërmoi detyrën për të shkruar “Mesharin” e tij. Në

të folmen e Drenicës vërehet përdorimi i shpeshtë i fjalës “gja” në vend të “gjë”. Vërehet gjithashtu një ngjashmëri e madhe mes fjalës “shkruomit” të Buzukut dhe “shkrumit” të të folmës në Drenicë.

Këto dy fjalë qëi morëm si shëmbuj këtu janë të përdorura specifikisht në Drenicë e shumë rrallë nëtreva të tjera. Që këto fjalë të mbijetojnë në pothuajse të njëjtën ortografi pas kaq shumë shekujsh është mjaft befasues duke konsideruar se variacionet gjuhësore ndodhin mjaft shpesh.


Në fjalinë e dytë të Pjetër Bogdanit vërehet folja “me pasun” dhe fjala përemri pronor “tinë”. Në të folmen e Drenicës paskajorja formohet nga pjesorja e foljesdhe pjesëza *me*: me ardh, me derdh, me lag, me la, me shti, me thy, me pas. Por, ndodh mjaft shpesh që paskajores t’i shtohet prapashtesa –un kur folja mbaron me bashtingëllore për shembull *me kapun, me pasun, me ardhun, me derdhun, etj.*

Sa i përket përemrit pronor “tinë” siq e ka përdorur Bogdani, në të folmen e Drenicës ky përemër del në formën “tina” për shembull: *këpuca e tina, libri i tina, ushqimi i tina, etj.*

Në figuracionin e paraqitur më lartë na del se 65% e të intervistuarve kanë hasur vëshirësi në të kuptuarit e plotë të këtyre dy fjalive. 10%, në anën tjetër, janë shprehur se nuk kanë aspak vështirësi në të kuptuarit e këtyre dy fjalive. Dhe në fund 25% e tyre janë shprehur se hasin në pak vështirësi.

8. Sa e vështirë ju duket gjuha e sotme shqipe që flitet në media (agjensi të lajmeve, muzikë, film, etj.)?

■ Aspak ■ ngapak ■ Shumw



Në kohën moderne, në gjuhën shqipe përdoret masivisht gjuha standarde e unifikuar në të gjitha mediat, ndikimi i të cilave është i jashtëzakonshëm. Dialekti i Drenicës mund të hasë në disa dallime në aspektin fonologjik dhe semantike, sidomos në fjalët që mediat i huazojnë nga anglishtja apo frëngjishtja.

Banorët e Drenicës njihen si njerëz që shpeshherë kanë qenë kyq në vendimmarrje politike të Kosovës, prandaj edhe interesimi i tyre për media, sidomos television dhe internet, mbetet mjaft i madh.

Sidoqoftë, këta banorë, sidomos ata që i përkasin një moshe më të moshuar, hasin në telashe kur moderatorët dhe reporterët e lajmeve përdorin fjalë më të komplikuara që rrallë herë përdoren në fjalorin bazë të Drenicakëve, si për shembull fjalët: *emancipim, negociata, integrim, nocion, transatlantike, stabilitet, etj.*

Figura më lart, që paraqet statistikisht përgjigjet e Drenicakëve rreth vështirësive që hasin në të kuptuarin e fjalorit që përdoret sot në media, na shfaq disa përqindje mjaft interesante. 65% e të intervistuarve janë shprehur se nuk hasin në asnjë problem gjatë leximit apo dëgjimit të lajmeve, shoëbizit, apo komentimit të sportit në television apo internet, ndërsa 30% janë shprehur se hasin ngapak probleme.


Nga këta, më së shumti kanë qenë qytetarë të moshës mbi 50 vjeqare, që nuk i kanë përvetsuar fjalët e hyra rishtazi në fjuhën shqipe nga anglishtja. Fare në fund, 5% e tyre janë shprehur se hasin në shumë probleme në këtë aspekt.

Këto të dhëna janë nxjerrë derisa të intervistuarit kanë marrë mundimin që të lexojnë paragrafin më poshtë, nxjerrë nga portali mediatik *Telegrafi*:

“Besojmë se shanset janë reale. Besojmë se ka vullnet te të dyja palët. Më e rëndësishmja, ka një dëshirë të madhe te të gjithë njerëzit në rajon që të jetojnë në paqe, të gjejnë mënyra për të ecur përpara, me synimin për integrim të plotë në institucionet evropiane dhe transatlantike dhe për të gjetur mënyra për siguri më të mirë, për stabilitet dhe mirëqenie për të gjithë njerëzit në rajon.” (Telegrafi, 2019, fq. 4)

Ndër këto fjalë, vetëm fjalët *integrim, transatlantike, dhe stabilitet* kanë paraqitur probleme semantike për grupin e të intervistuarve me statistikën prej 5% që faktikisht përbëjnë vetëm fjalët me prejardhje nga anglishtja, pra: *integration, transatlantic, stability*.

9. Sa prej këtyre fjalëve i njihni?




Pyetja e paraqitur në grafikonin më lart i është shtruar popullacionit prej 100 personave. Fjalët e cekura në pyetje i takojnë të folmes së Moravës së Epërme e cila është vetëm 100 kilometra larg Drenicës. Pyetja është bërë me qëllim që të bëhet një krahasim mes fjalëve të rëndomta që përdoren shpesh në një trevë tjetër jashtë Drenicës dhe të verifikohet se sa prej këtyre fjalëve njihen nga banorët e Drenicës.

Statistikat e nxjerra na shfaqin një grafikon mjaft frytdhënës në aspektin e mbështetjes së nocionit se variacionet gjuhësore në Kosovë shpeshherë dinë të jenë mjaft të theksuara. Më poshtë do të gjeni fjalët e lrtpërmendura në dialektin e Drenicës:

- Gujë – jakne, xhaketë
- Kapixhik – zastoje (e huazur nga serbishtja)
- Citap – Kuran, libri i shenjtë

- Çardak – Sallon ndeje, odë
- Dyrek – tra, dërrasë mbështëtse
- Kashore – kafshatë

Edhe pse nga përqindjet shihet se një numër i banorëve të Drenicës i njohin këto fjalë, edhe pse nuk i përdorin në të folmen e tyre, numri më i madh i tyre përbën popullatën më të vjetër të tyre. Pra, mund të thuhet se të rinjtë e Drenicës i njohin shumë pak apo fare këto fjalë që vetëm 100 kilometra më larg përdoren çdo ditë.



Është faktike se një apo një grup personsh të cilët mund të kenë ndikim të madh në jetën politike apo në ndonjë sferë tjetër të jetës doemos do të kenë ndikim edhe në gjuhën që flitet në atë rajon.

Këtë pyetje kemi vendosur t'ua shtrojmë të anketuarve pasi që është një ndërlidhje mjaft pak e përmendur në librat sociolinguistik.

Në librin “ Gjermania: kujtimet e një kombi” autori anglez Neil Macgregor përmend se në një kohë kur Gjermania ishte ndarë në qindra provinca të ndryshme të cilat flisnin variacione të ndryshme të gjuhës së njëjtë. pra asaj gjermane, një njeri, i vetëm, kishte arritur t’i bashkonte përmes përkthimit të Biblës, të përkthyer me mjeshtri duke përdorur fjalë të gjermanishtes së lartë dh asaj të ulët ose vulgare: Martin Luteri.

Pra, brenda një kohe të shkurtër, pothuajse të gjithë filluan të shkruanin dhe të flisnin në gjuhën e njëjtë. Ky është ndikimi që mund të ketë një njeri në zhvillimin apo ndryshimin e një dialekti në një tjetër apo stadardizimin e plotë të një dialekti në gjuhë.

Në Drenicë njëqind të anketuarit, sipas përgjigjeve, janë ndarë në dy grupë pothuajse të barabarta: 51% e tyre janë shprehur se Drenicasit me ndikim kanë luajtur rol në këtë aspekt, ndërsa 49 të tjerë, në anën tjetër, janë shprehur të kundërtën.

Kapitulli i pestë

5.1 Përfundimi

Për përfundim mjafton të theksohet se ky punim diplome është një risinë temën e gjerë të dialekteve në gjuhën shqipe sepse, siç është përmendur në fillim, ka pasur fare pak studime apo analiza rreth të folmes së Drenicës në të kaluarën.

Ky studim ka arritur të sqarojë disa prej veqorive kryesore morfologjike (emiri, mbiemri, nyja, rasat , etj.), semantike dhe fonologjike të këtij sociolekti dhe gjeolekti. Për të arritur në konkluzionet e paraqitura gjatë këtij punimi janë marr për bazë një varg veprash të rëndësishme që janë shkruar në lidhje me dialektologjinë e përgjithshme të gjuhës sonë si dhe është bërë një studim në terren përmes një pyetsori prej dhjetë pyetjeve qëi janë përgjigjur njëqind persona të të dy gjinive dhe moshave të ndryshme. Përgjigjet e tyre janë paraqitur në mënyrë grafike dhe nga e kanë ofruar një pasqyrë të qartë rreth ndryshimeve të të folurit të tyre për dallim nga disa dialekte të tjera.

Një aspekt tjetër i këtij punimi është edhe krahasimi mesë folmes së Drenicës dhe gjuhës së vjetër shqipe, kryesisht të marra nga shkrimet e hershme të Buzikut, Bogdanit, apo edhe të disa shkrimtarëve të tjerë më të vonshëm si për shembull Naim Frashëri, Asdreni, etj. Ngjashmëritë dhe dallimet e vërejtura janë një gjë e re për publikun shqiptar dhe mjaft interesante.

Në fund fare është theksuar edhe ndikimi i klasës sociale si dhe personave me ndikim në rajonin e Drenicës në vazhdimin e këtij dialekti dhe mbijetesën e tij në një kohë kur ndikim mediatik tenton, me apo pa dashje, të formojë vetëm një gjuhë të vetme standarde, e cila gjë do të varfëronte gjuhën tonë tëëmbël shqipe.

Bibliografia

Ajeti, I. (1969). *“Rreth disa veçorive të të folmeve të shqiptarve të rrethit të Preshevës e Bujanovcit*, Gjurmime Albanologjike 2.

Pajaziti, N. (2015). *“Shqipja standarde dhe dialektet”*. Prishtinë. Instituti Albanologjik

Bardhi, M. (1975). *“Gjurmime Albanologjike”*. Prishtinë.

Beci, B. (1970). *“Grupi përëndimor i nëndialektit verior të gegërishtes”*. Tiranë.

Beci, B. (1971). *“Dialektologjia Shqiptare I”*. Tiranë.

Bejta, B. (2007). *“Gjuha dhe të folurit”*. Prishtinë.

Çetta, A. (1972). *“Prozë popullore nga Drenica (I – II)*. Prishtinë

Demiraj, Sh. (1973). *“Morfologjia historike e gjuhës shqipe.”* Tiranë.

Hajdaraj, A. (1996). *“E folmja e Rugoves”*. Prishtinë.

Kajtazi, H. (1970). *“Proza popullore e Drenicës I”*. Prishtinë.

Kelmendi, H. (1976). *“E folmja e lokalitetit të Turiqevcit”*. Prishtinë.

Kelmendi, H. (1975). *“Disa veçori fonetike në të folmen e fshatit Brojë”*, Dituria, nr. 1-2, Prishtinë.

Kadriu Zeqir, *Dialektete dhe të folmet e shqiptarëve në Maqedoni,”Albas”, Tiranë, 2004*

Kadriu Zeqir, Norma e shqipes standarde, "Arbëria Desing", Tetovë, 2007

Halimi, M. (1974). *Disa tipare të së folmes së Moravës së poshtme*", Gjurmime albanologjike,

II. Prishtinë

Halimi, M. (2000). *"E folmja e Karadakut (punim në dorëshkrim)*", Prishtinë.

Mulaku, L. (1968). *"E folmja shqipe e Shalës së Bajgores"*. Prishtinë.

Mehmetaj, B. (1980). *"Morfologjia dhe fjalëformimi në të folmen e Deçanit"*. Prishtinë.

Nuhiu, V. (1990). *"Ndikimet ndërgjuhësore"*, Prishtinë.

Shkurtaj, Gj. (2003). *"Pasuri leksikore e gegërishtes dhe gjuha e njësuar"*. Tiranë.

Shkurtaj, Gj. (2003). *"Kahe dhe dukuri të kultures së gjuhës shqipe"*. Tiranë.

Thomai, J. (2006). *"Leksikologjia e gjuhës shqipe"*. Tiranë.